



KOMUNA MALISHEVË ZYRA PËR BARAZI GJINORE



Datë:09.07.2026
Nr:01/1128

Raporti punës – Janar-Qershor 2026

Raporti i punës për gjashtëmujorin e parë paraqet një përmbledhje të aktiviteteve, angazhimeve dhe rezultateve të arritura nga Zyra për Barazi Gjinore në realizimin e mandatit dhe përgjegjësi gjatë periudhës raportuese. Raporti në fjalë pasqyron punën e zhvilluar në funksion të promovimit të barazisë gjinore, garantimit të mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët dhe integritetit të perspektivës gjinore në politikën, programet dhe proceset vendimmarrëse në nivel komunal.

Në raport me Ligjin për Barazi Gjinore, Programin Kombëtarë për Barazi Gjinore dhe strategjitë, Zyra ka vazhduar të ushtrojë rolin koordinues, këshillues dhe monitorues në zbatimin e politikave të barazisë gjinore.

Gjatë kësaj periudhe janë ndërmarrë aktivitete të shumta në bashkëpunim me drejtoritë komunale, institucionet publike, organizatat e shoqërisë civile dhe bashkëpunëtorët, me synim fuqizimin e rolit të gruas në shoqëri, parandalimin e diskriminimit në baza gjinore, promovimin e pjesëmarrjes së barabartë në jetën publike dhe avancimin e të drejtave të njeriut.

Raporti gjithashtu ofron një pasqyrë të sfidave gjatë zbatimit të aktiviteteve, si dhe rekomandime dhe prioritet për periudhën e ardhshme, me qëllim rritjen e efektivitetit të veprimeve institucionale dhe përmbushjen e objektivave strategjike në fushën e barazisë gjinore.

Përmes këtij raporti synohet të sigurohet transparencë dhe llogaridhënie për punën e Zyrës për Barazi Gjinore, duke kontribuar njëkohësisht në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe në përmirësimin e vazhdueshëm të mekanizmave lokalë për promovimin e barazisë dhe gjithëpërfshirjes.

Puna dhe aktivitetet e realizuara përgjatë gjashtë-mujorit të parë 2026



Në kuadër të promovimit të mirëqenies së të rinjve, realizuam një takim informues dhe ndërgjegjësues me të rinj dhe të reja, me fokus në rëndësinë e shëndetit mendor dhe ndikimin pozitiv të aktiviteteve fizike në përmirësimin e cilësisë së jetës.

Gjatë takimit u diskutua për sfidat me të cilat përballen të rinjtë në jetën e përditshme, si stresi, ankthi, presioni social dhe rëndësia e kërkimit të mbështetjes kur është e nevojshme.

Pjesëmarrësit u informuan për mënyrat e ruajtjes së shëndetit mendor përmes komunikimit të hapur, menaxhimit të emocioneve dhe krijimit të zakoneve të shëndetshme.

Në pjesën praktike të aktivitetit u zhvilluan ushtrime dhe aktivitete fizike rekreative, duke theksuar se lëvizja e rregullt ndikon pozitivisht në shëndetin fizik dhe mendor, ul nivelin e stresit, përmirëson humorin dhe forcon bashkëpunimin mes të rinjve.

Takimi u karakterizua nga pjesëmarrje aktive, diskutime konstruktive dhe angazhim i të rinjve, duke kontribuar në rritjen e vetëdijes për rëndësinë e kujdesit ndaj shëndetit mendor dhe përfshirjen e aktivitetit fizik si pjesë e stilit të shëndetshëm të jetës.


poashtu në bluzat e bardha është i shkruar edhe mesazhi:

“ZGJIDH JETËN AKTIVE, CDO DITË VLENË”



Në kuadër të përmbylljes së aktiviteteve vjetore, u organizua një takim me përfaqësues të institucioneve komunale, organizatave të shoqërisë civile dhe partnerëve bashkëpunues, me qëllim të vlerësimit të bashkëpunimeve të realizuara gjatë vitit, prezantimit të të arriturave dhe identifikimit të sfidave në fushën e barazisë gjinore, të drejtave të njeriut dhe mbrojtjes nga diskriminimi.

Gjatë takimit u prezantuan aktivitetet dhe iniciativat e zhvilluara gjatë vitit, duke theksuar bashkëpunimin ndërinstitucional në organizimin e fushatave ndërgjegjësuere, ligjëratare, punëtorive dhe aktiviteteve të realizuara. Në përgjithësi diskutuam mbi rezultatet e arritura, praktikat e mira dhe ndikimin e aktiviteteve në rritjen e ndërgjegjësimit të komunitetit. Takimi përfundoi me rekomandime për avancimin e bashkëpunimit mes institucioneve dhe , planifikimin e aktiviteteve të ardhshme dhe forcimin e mekanizmave lokalë për promovimin e barazisë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe luftimin e diskriminimit, me synim krijimin e një shoqërie më gjithëpërfshirëse dhe të barabartë për të gjithë qytetarët.



Në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë u organizua një sesion informues me gra, fermere me qëllim të promovimit të fuqizimit ekonomik të grave dhe rritjes së informimit mbi mundësitë për përfitim nga subvencionet dhe grantet në sektorin e bujqësisë. Gjatë sesionit, përfaqësuesit e Drejtorisë së Bujqësisë prezantuan programet mbështetëse, kriteret e aplikimit, dokumentacionin e nevojshëm dhe afatet për përfitimin e subvencioneve dhe granteve. Pjesëmarrëset u informuan gjithashtu për mundësitë që këto skema ofrojnë për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore, rritjen e të ardhurave familjare dhe krijimin e bizneseve të qëndrueshme.




Bashkëpunimi me nxënësit gjatë realizimit të projektit për promovimin e vlerave humane ishte një përvojë e suksesshme dhe frytdhënëse. Gjatë diskutimeve të përbashkëta nxënësit përzgjedhën temën **parandalimi i dhunës në familje** me synimin për të rritur ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e respektit, mbështetjes dhe komunikimit të shëndetshëm brenda familjes. Falë angazhimit, përkushtimit dhe punës ekipore të nxënësve, projekti u vlerësua me vendin e dytë në nivel të Kosovës, duke dëshmuar rëndësinë e bashkëpunimit dhe fuqinë e të rinjve në promovimin e vlerave humane.

Java e Edukimit për Barazi Gjinore

Ligjërata dhe punëtori në shkollë

Në kuadër të Javës së Edukimit për Barazi Gjinore u organizuan ligjërata dhe punëtori në të gjitha shkollat e komunës. Aktivitetet kishin për qëllim sensibilizimin e nxënësve për rëndësinë e barazisë gjinore, respektimin e të drejtave të njeriut, promovimin e mundësive të barabarta dhe luftimin e stereotipeve gjinore. Përmes diskutimeve interaktive, nxënësit u inkurajuan të reflektojnë mbi rolin e tyre në ndërtimin e një shoqërie të barabartë dhe gjithëpërfshirëse.



Mesazhe për promovimin e barazisë gjinore

Si pjesë e aktiviteteve ndërgjegjësuere, nxënësit përgatitën dhe prezantuan thënie me mesazhe që promovojnë barazinë gjinore. Secili nxënës vendosi nga një thënie në një tabelë të përbashkët simbolike, duke krijuar një mozaik mesazhesh që pasqyronte angazhimin e tyre për promovimin e barazisë, respektit dhe mosdiskriminimit.



Takim me grupin e grave dhe bashkëpunëtoret

Një takim me gratë bashkëpunëtoresh me rastin e Javës së Edukimit për Barazi Gjinore ishte një mundësi e rëndësishme për të diskutuar mbi rolin, kontributin dhe fuqizimin e grave në shoqëri. Gjatë këtij takimi u trajtuan tema që lidhen me barazinë gjinore, respektimin e të drejtave të grave, bashkëpunimin dhe krijimin e mundësive të barabarta për të gjithë. Përmes shkëmbimit të përvojave dhe ideve, u theksua rëndësia e mbështetjes së ndërsjellë dhe e angazhimit të përbashkët në promovimin e një shoqërie më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.



Vizitë te busti i Nexhmije Pagarushës

Në shenjë respekti dhe vlerësimi për figurat e shquara të gruas shqiptare, u realizua një vizitë te busti i Nexhmije Pagarushës. Përmes kësaj vizite u nderua kontributi i saj i jashtëzakonshëm në kulturën dhe artin shqiptar, duke e prezantuar atë si model frymëzimi për brezat e rinj dhe si simbol të suksesit dhe dinjitetit të gruas.



Ndarja e mirënjohjeve për gratë kontributdhënëse

Në kuadër të aktiviteteve u organizua ceremonia e ndarjes së mirënjohjeve për gratë kontributdhënëse të komunës. Mirënjohjet iu ndanë grave që, përmes angazhimit të tyre profesional, institucional, social dhe humanitar, kanë dhënë kontribut të çmuar në zhvillimin e komunitetit dhe avancimin e pozitës së gruas në shoqëri(familje të dëshmorëve, arsim, shëndetësi, sport dhe biznes).



Promovimi i librit autobiografik

Në përmbyllje të Javës së Edukimit për Barazi Gjinore u organizua promovimi i librit autobiografik të shkruar nga një grua (**Filloreta Gashi-me titull Kur Dhimbja Më Rriti**) në të cilin rrëfihen jeta e saj, sfidat personale dhe përjetimet gjatë luftës së fundit në Kosovë. Ky aktivitet synoi të promovojë zërin e grave, të ruajë kujtesën historike dhe të vlerësojë forcën, qëndresën dhe kontributin e grave në periudha të vështira.



Në bashkëpunim me Agjencin për Barazi Gjinore realizuam trajnimin me akterët e Mekanizmit Koordinues Lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna me Bazë Gjinore.

Trajnimi kishte për qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të mekanizmit, si dhe avancimin e praktikave për mbrojtjen efektive të viktimave të dhunës. Gjatë aktivitetit u theksua rëndësia e reagimit të koordinuar ndërmjet institucioneve dhe zbatimit të qëndrueshëm të politikave për barazi gjinore në nivel lokal.

Poashtu u diskutua edhe për bashkëpunimet e radhës nga fusha të ndryshme që nderlidhen me të drejtat e grave dhe fuqizimin e tyre.





Në kuadër të promovimit të fuqizimit ekonomik të grave në zonat rurale, u realizua vizita së bashku me LMT si bashkëpunëtorë të ZBGJ, të fermerja e cila merret me kultivimin dhe përpunimin e perimeve. Qëllimi i vizitës ishte njohja me aktivitetin e saj bujqësor, sfidat me të cilat përballet dhe mundësitë për zhvillimin e mëtejshëm të biznesit të saj.

Gjatë takimit u diskutua për rëndësinë e përfshirjes së grave në sektorin e bujqësisë, përvojën e saj në kultivimin dhe përpunimin e perimeve, si dhe për rolin që kjo veprimtari ka në sigurimin e të ardhurave familjare dhe zhvillimin ekonomik lokal. Gjithashtu, u shkëmbyen informacione lidhur me mundësitë e mbështetjes institucionale, subvencionet dhe grantet për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore.



Në bashkëpunim me Policinë e Kosovës u organizua një fushatë sensibilizuese me nxënës të shkollave, me qëllim të rritjes së ndërgjegjësimit për parandalimin e ngacmimeve seksuale, njohjen e formave të tyre dhe rëndësinë e raportimit të çdo rasti.

Gjatë aktivitetit, përfaqësuesit e Policisë dhe pjesëmarrësit diskutuan mbi të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve për një mjedis të sigurt, format e ngacmimeve seksuale, pasojat që ato shkaktojnë dhe mekanizmat institucionalë për mbrojtje dhe raportim. Nxënësit u inkurajuan të flasin hapur, të kërkojnë ndihmë dhe të mos tolerojnë asnjë formë të dhunës apo ngacmimit.

Në kuadër të fushatës u shpërndanë materiale vetëdijesuese dhe u zhvilluan diskutime interaktive, duke promovuar respektin reciprok, barazinë gjinore dhe krijimin e një ambienti të sigurt në shkollë dhe në komunitet. Aktiviteti kontribuoi në forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe në rritjen e vetëdijes së të rinjve për parandalimin dhe raportimin e ngacmimeve seksuale.

Të rinjtë kundër dhunës në familje, aktivitete ndërgjegjëse.

Përmes diskutimeve në grup dhe punës praktike, të rinjtë u njohën me format e dhunës në familje, mekanizmat e mbrojtjes, rolin e institucioneve dhe rëndësinë e raportimit të rasteve. Aktiviteti nxiti reflektim, mendim kritik dhe angazhim aktiv për ndërtimin e një shoqërie më të sigurt dhe më të drejtë për të gjithë,

Të rinjtë dolën me mesazhin: ndryshimi fillon me informim, vazhdon me veprim dhe forcohet kur komuniteti bëhet pjesë e tij.



Aktiviteti 1 Qershori Poetik i Fëmijëve mbledhi nxënës, poetë, dhe dashamirë të kulturës në një festë të veçantë kushtuar fjalës së bukur.

Në këtë takim përveq fëmijëve krijues morën pjesë edhe poetë nga Shoqata për Kulturë dhe Letërsi “Tafil Kelmendi” në Malishevë, të cilët, së bashku me nxënësit, lexuan poezi dhe ndanë përvoja krijuese.

Fëmijët jo vetëm recituan vargjet e tyre, por edhe shkëmbyen histori, ide dhe ëndrra, duke dëshmuar se krijimtaria mbetet një nga format më të fuqishme të shprehjes së lirë.

Atmosfera u karakterizua nga emocione, duartrokitje dhe mesazhe frymëzuese për një të ardhme ku libri, arti dhe kultura do të vazhdojnë të jenë udhërrëfyes të brezave të rinj.

Ky aktivitet dëshmoi se investimi në kulturën e fëmijëve është investim në të ardhmen e shoqërisë. Në Malishevë, 1 Qershori nuk ishte vetëm festë, por edhe një thirrje për më shumë hapësirë, vëmendje dhe mbështetje për talentin e ri krijues.





Në kuadër të promovimit të fuqizimit ekonomik të grave dhe vajzave, realizuam një vizitë tek një krijuese e cila ushtron veprimtarinë e saj artizane nga shtëpia. Qëllimi i vizitës ishte njohja nga afër me punën, sfidat dhe sukseset e saj, si dhe inkurajimi i grave dhe vajzave për të zhvilluar iniciativa të ngjashme sipërmarrëse.

Gjatë takimit u diskutua për rëndësinë e vetëpunësimit, zhvillimin e aftësive artizanale dhe mundësitë për zgjerimin e aktivitetit përmes mbështetjes

institucionale dhe programeve të ndryshme. U vlerësua përkushtimi dhe kreativiteti i saj në krijimin e punimeve artizanale, të cilat përbëjnë një burim të rëndësishëm të të ardhurave dhe një shembull pozitiv të fuqizimit ekonomik.

Kjo vizitë shërbeu si një mundësi për të promovuar punën e grave dhe vajzave që zhvillojnë veprimtari ekonomike nga shtëpia, duke nxitur mbështetjen e tyre dhe duke rritur ndërgjegjësimin për rëndësinë e krijimit të mundësive të barabarta për pjesëmarrje në jetën ekonomike.

Në bashkëpunim me zyrtarin për Ndihmë Juridike Falas dhe përfaqësues të institucioneve të tjera relevante, u zhvillua një aktivitet në zyrën e kryetarit me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërinstitutional dhe informimin e qytetarëve për shërbimet e ndihmës juridike falas.

Gjatë takimit u diskutua për rëndësinë e koordinimit ndërmjet institucioneve, mënyrat e referimit të rasteve, si dhe për ofrimin e qasjes sa më të lehtë të qytetarëve në shërbimet juridike falas.



Në një atmosferë diskutimi dhe bashkëpunimi, u mbajt takimi me temën “Roli i Grave në Listat Zgjedhore dhe Rëndësia e Tyre në Vendimmarrje”,
Në këtë aktivitet morën pjesë, zyrtarë administrativë, përfaqësues të organizatave joqeveritare, si dhe përfaqësues të subjekteve politike.
Gjatë takimit u diskutua për fuqizimin e rolit të grave në proceset vendimmarrëse, sfidat me të cilat ato përballen dhe rëndësia e përfaqësimit të barabartë në institucionet publike.
Duke theksuar nevojën për një pjesëmarrje më të madhe dhe më cilësore të grave në jetën politike, nga të pranishmit u theksua se përfshirja e grave në listat zgjedhore dhe në vendimmarrje nuk duhet të shihet vetëm si përmbushje e kuotës gjinore, por si një vlerë dhe domosdoshmëri për zhvillimin demokratik të shoqërisë.
Pjesëmarrësit vlerësuan se rritja e rolit të grave në politikë dhe institucione kontribuon në vendimmarrje më gjithëpërfshirëse, më të drejtë dhe më afër nevojave të qytetarëve.



Gjatë periudhës gjashtëmuajore,Zyra për Barazi Gjinore ka vazhduar angazhimin e saj në promovimin e barazisë gjinore, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe fuqizimin e mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët. Aktivitetet e realizuara pasqyrojnë përkushtimin për zbatimin e politikave dhe legjisllacionit në fuqi, si dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet dhe partnerët përkatës.Megjithëse janë shënuar rezultate të rëndësishme, mbeten sfida që kërkojnë angazhim të vazhdueshëm, koordinim ndërinstitutional dhe ndërgjegjësim të mëtejshëm të shoqërisë. Zyra do të vazhdojë të punojë me përgjegjësi dhe transparencë për të avancuar barazinë gjinore dhe për të siguruar një mjedis gjithëpërfshirës, ku secili individ gëzon të drejta dhe mundësi të barabarta.

Koordinatorja NJDNJ dhe
Barazi Gjinore

Vera Bytyçi
